V E N D I M
Nr.130, datë 20.3.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.93, DATË 28.2.1994 "PËR BASHKIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRITË TREGTARE ME ORTAKË TË TJERË"

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.93, datë 28.2.1994 "Për bashkimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqërit tregtare me ortakë të tjerë", në pikën 1, paragrafi i parë, në rreshtin e fundit hiqen fjalët "... për t'u marrë vendim...".

2. Pas paragrafit të parë të pikës 1 shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

"Organet nga varet ndërmarrja duhet të paraqesin, së bashku me mendimin e tyre, dokumentet e parashikuara më sipër në Bordin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, i cili është i vetmi organ që jep miratimin për bashkimin e ndërmarrjeve në shoqëri tregtare me ortakë të tjerë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi